



Prot. No. _____

Podujevë, on ____/____/2026
____/____/2026

Prot. No. _____

Podujevë, on

Memorandum Mirëkuptimi (MM)

ndërmjet

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH zyra përfaqësuese për Kosovë, me adresë: Rr. Arkitekt Karl Gega 38, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës dhe Zmaja od Bosne 7-7a, 71000 Sarajevë, Bosnjë dhe Hercegovinë, e përfaqësuar nga z. **David Oberhuber, Drejtor i GIZ për Kosovë dhe Maqedoni të Veriut,**

Dhe

Komunës së Podujevës, me adresë: Rr. Nuhi Gashi, Kodi Postar: 11000 Podujevë, e përfaqësuar nga z. **Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës së Podujevës, on**

(Në vijim të referuara bashkërisht si "Partnerët")

Hyrje

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH (në vijim "GIZ") është një ndërmarrje në pronësi të Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe ofron shërbime në mbarë botën në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar për zhvillim të qëndrueshëm dhe edukimit në nivel ndërkombëtar. GIZ është i ngarkuar me detyra kryesisht nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ.).

Komuna e Podujevës (në vijim "Komuna") është një nga komunat zyrtare në Republikën e Kosovës.

Ky Memorandum Mirëkuptimi (në vijim: "Memorandumi") shpreh synimin e partnerëve për të bashkëpunuar në vendosjen e një rrjeti Wi-Fi në Komunën e Podujevës në kuadër të iniciativës "WiFi4WB", si pjesë e projektit EU4Digital, i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian dhe Qeveria e Gjermanisë dhe i zbatuar nga GIZ në kuadër të projektit më të gjerë "Bashkëpunimi Rajonal për Integrim në BE (RCEI)".

Partnerët shprehin interesin për bashkëpunim më të ngushtë, që mund të përfshijë aktivitete të përbashkëta për të ofruar qasje falas, publike dhe të sigurt në internet për qytetarët dhe vizitorët e Komunës së Podujevës përmes instalimit të infrastrukturës përkatëse të rrjetit pa tela në lokacione të përzgjedhura publike, në përputhje me kushtet e këtij Memorandumi dhe sipas udhëzimeve të operatorit të telekomunikacionit.

Ky Memorandum nuk përbën marrëveshje juridikisht detyruese, por vetëm një konfirmim të synimit për bashkëpunim, bazuar në besim të ndërsjellë dhe në ndjekjen e qëllimeve të përbashkëta.

Qëllimi

GIZ dhe Komuna synojnë të bashkëpunojnë për instalimin e suksesshëm të një rrjeti Wi-Fi në Komunën e Podujevës në kuadër të iniciativës "WiFi4WB", që përfshin:

Neni 1

- 1.1. Identifikimin e lokacioneve optimale për instalimin e rrjetit Wi-Fi falas.
- 1.2. Instalimin, testimin dhe funksionalizimin e rrjetit Wi-Fi.
- 1.3. Ofrimin e qasjes falas në internet për publikun për një periudhë prej së paku 18 (tetëmbëdhjetë) muajsh, në përputhje me kushtet e këtij Memorandumi.
- 1.4. Sigurimin e qëndrueshmërisë së rrjetit Wi-Fi pas përfundimit të mbështetjes financiare.
- 1.5. Bashkëpunimin me operatorin e telekomunikacionit **Kosovo Telecom Sh.A.** –

Vala, i cili vepron si zbatues i iniciativës WiFi4WB dhe që do të transferojë të drejtat pronësore mbi pajisjet tek Komuna.

Neni 2

GIZ synon:

- 2.1. Të kontraktojë Kosovo Telecom Sh.A. – Vala si operator të autorizuar për të siguruar pajisjet, për të realizuar instalimin dhe për të ofruar shërbimin e internetit dhe mirëmbajtjen për së paku 18 muaj.
- 2.2. Të asistojë në procesin e transferimit të pronësisë së pajisjeve tek Komuna.
- 2.3. Të ndërmarrë aktivitete për sigurimin e burimeve financiare për vazhdimin e mbështetjes edhe për një periudhë shtesë prej 18 muajsh.

GIZ nuk mban përgjegjësi për dëmet që lidhen me pajisjet apo përdorimin e tyre nga Komuna apo palë të treta.

Neni 3

Komuna synon të ndërmarrë veprimet në vijim:

- 3.1. Të caktojë një person kontaktues përgjegjës për komunikimin dhe koordinimin me operatorin e angazhuar të telekomunikacionit dhe me GIZ.

Emri i personit:: Labinot Kajtazi

E-mail: labinot.kajtazi@rks-gov.net.

Telefoni: +38344600596

Për çdo ndryshim të personit kontaktues, Komuna do të njoftojë GIZ pa vonesë.

- 3.2. Në bashkëpunim me operatorin e telekomunikacionit, të përcaktojë dhe propozojë lokacionin(et) e sakta ku do të instalohen pajisjet dhe pikat e qasjes Wi-Fi, duke marrë parasysh kërkesat teknike dhe të sigurisë, si dhe interesin publik.

- 3.3. Të sigurojë të gjitha vendimet e nevojshme të brendshme, si dhe miratimet, lejet dhe licencat nga autoritetet e tjera kompetente në [Emri i shtetit], të nevojshme për instalimin dhe funksionimin e ligjshëm të rrjetit Wi-Fi në lokacionet e propozuara (duke përfshirë lejet për shfrytëzimin e hapësirave publike, lejet ndërtimore, si dhe kushtet dhe miratimet e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për komunikimet elektronike, mbrojtjen e të dhënave personale dhe sigurinë e sistemeve të informacionit, etj.), dhe njëkohësisht të respektojë legjislacionin në fuqi në [Emri i shtetit].

3.4. Të sigurojë qasje falas në një burim/lidhje të përshtatshme të energjisë elektrike për secilin lokacion, të nevojshme për furnizimin dhe funksionimin e pajisjeve.

3.5. Të sigurojë mbrojtjen e duhur të pajisjeve të instaluar në objektet e saj ose në hapësirat publike nën kompetencën e saj dhe të ndërmarrë masa për parandalimin e dëmtimit dhe vjedhjes.

3.6. Pas përfundimit të periudhës fillestare të mbështetjes prej 18 (tetëmbëdhjetë) ose 36 (tridhjetë e gjashtë) muajsh, synon të vazhdojë ofrimin e shërbimit falas të internetit pa tela dhe mirëmbajtjen e pajisjeve për një periudhë shtesë prej së paku 12 (dymbëdhjetë) muajsh. Komuna do të ketë të drejtë ta ofrojë shërbimin në bashkëpunim me të njëjtin operator të telekomunikacionit, ose të përzgjedhë një operator tjetër.

3.7. Të respektojë të gjitha udhëzimet e dhëna nga operatori i telekomunikacionit në lidhje me përdorimin e pajisjeve; dhe nëse bashkë me pajisjet dorëzohet sigurim, të respektojë kushtet e përcaktuara nga kompania kompetente e sigurimit.

Për këtë qëllim, partnerët mund të shqyrtojnë dhe koordinojnë bashkërisht aktivitetet e sipërpërmendura me interes të ndërsjellë, të cilat do të zbatohen përmes marrëveshjeve të veçanta, në mirëkuptim të ndërsjellë dhe në përputhje me rregulloret dhe politikat e të dy partnerëve.

Kohëzgjatja

Ky Memorandum Mirëkuptimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga partnerët dhe do të përfundojë në datën e përfundimit të të gjitha aktiviteteve të parashikuara në të. Ndryshimet dhe plotësimet e këtij Memorandumi mund të bëhen vetëm me pëlqimin e ndërsjellë me shkrim të partnerëve.

Natyra jo detyruese

Asgjë në këtë Memorandum Mirëkuptimi nuk duhet të kuptohet ose interpretohet si një e drejtë ose detyrim ligjor i partnerëve, apo si detyrim i partnerëve nënshkrues për të lidhur përfundimisht ndonjë marrëveshje. Në veçanti, ky Memorandum Mirëkuptimi nuk kufizon në asnjë mënyrë asnjë prej partnerëve nga ndjekja e aktiviteteve të ngjashme me iniciativën e tyre, ose nga pjesëmarrja në aktivitete të ngjashme me agjenci, organizata dhe individë të tjerë publikë ose privatë, si dhe nuk ofron ekskluzivitet ndërmjet Partnerëve në fushën e asnjë bashkëpunimi, nuk përkrah një subjekt specifik, nuk gjeneron asnjë të drejtë mbi asnjë person dhe nuk krijon asnjë detyrim për asnjë palë të tretë.

Ky Memorandum nuk krijon dhe nuk duhet të interpretohet sikur krijon detyrime financiare apo të llojeve të tjera për partnerët. Çdo detyrim i marrë përsipër nga njëra prej palëve në kuadër të këtij Memorandumi, është subjekt i disponueshmërisë së burimeve, aspekteve specifike dhe vendimit të partnerit përkatës që e merr përsipër. Ndërmjet partnerëve mund të vendoset një marrëdhënie kontraktuale detyruese vetëm duke lidhur një marrëveshje të veçantë me shkrim. Çdo mosmarrëveshje që

mund të lindë për sa i përket interpretimit dhe zbatimit të këtij Memorandumi zgjidhet me mirëkuptim, në frymën e bashkëpunimit dhe të respektit të ndërsjellë. Ky Memorandum përgatitet në versionet në gjuhën Shqipe dhe në gjuhën angleze; në rast të ndonjë mospërputhjeje, versioni në gjuhën angleze do të mbizotërojë.

Ky Memorandum nënshkruhet në dy (2) kopje origjinale identike, nga një (1) për secilin partner.

Bazuar në sa më lart dhe pas arritjes së mirëkuptimit të ndërsjellë, partnerët, duke vepruar me vullnetin e tyre të lirë, nënshkruajnë këtë Memorandum si në vijim

**Deutsche Gesellschaft für
Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH**

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I GIZ

për Kosovë dhe Maqedoni të Veriut

David Oberhuber



Komuna e Podujevës

KRYETARI

Shpejtim Balliqi





Prot. No. _____

Prot. No. _____

Podujevë, on ____/____/2026
____/____/2026

Podujevë, on

Memorandum of Understanding (MoU)

between

Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, representative office for Kosovo, with address: St. Arkitekt Karl Gega 38, 10000 Pristina Republic of Kosovo and Zmaja od Bosne 7-7a, 71000 Sarajevo, Bosnia and Herzegovina, represented by **Mr. David Oberhuber** GIZ Country director for Kosovo and North Macedonia.

and

Municipality of Podujevë, with the address: St.Nuhi Gashi Postal Code: 11000 Podujevë, represented by **Mr. Shpejtim Bulliqi**, Mayor of the Podujevë Municipality.

Hereinafter referred to jointly as “the partners”

1. Introduction

The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH (hereinafter „GIZ“) is an enterprise owned by the Government of the Federal Republic of Germany and provides services worldwide in the field of international cooperation for sustainable development and international education. GIZ is mainly commissioned by the German Federal Ministry for Economic Cooperation and Development (BMZ).

Municipality of Podujevë (hereinafter „Municipality“) is one of the official municipalities in Republic of Kosovo

This Memorandum of Understanding (hereinafter: the “Memorandum”) expresses the partners’ intention to cooperate for the deployment of a Wi-Fi network in Municipality of Podujevë within the “WiFi4WB” initiative as part of the EU4Digital Project, co-financed by the European Union and the Government of Germany and implemented by GIZ as part of the broader project “Regional Cooperation for EU Integration (RCEI)”.

Partners hereby express their interest in a closer collaboration that may include joint activities to provide free, public, and secure access to the internet for the citizens and visitors of the Municipality of Podujevë through the installation of appropriate wireless network infrastructure at selected public locations, in accordance with the conditions set out in this Memorandum and according to the instructions and conditions defined by the telecommunication operator. This Memorandum does not, in any case, constitute a legally binding agreement, but only a confirmation of the intention to cooperate based on mutual trust and the pursuit of common goals and interests.

2. Purpose

GIZ and Municipality endeavor to work together to successfully install a Wi-Fi network within the “WiFi4WB” initiative in the Municipality of Podujevë which entails:

Article 1

- 1.1.** Identifying optimal location(s) for the installation of the free Wi-Fi network.
- 1.2.** Installation, testing, and commissioning of the Wi-Fi network.
- 1.3.** Providing free internet access to the public for a period of at least 18 (eighteen) months, in accordance with the conditions set out in this Memorandum.
- 1.4** Ensuring the sustainability of the Wi-Fi network upon the expiry of the financial support.
- 1.5** Cooperating with the telecommunication operator Kosovo Telecom J.S.C Vala which serves as the implementing entity for the initiative WiFi4WB and it is the party that shall transfer the property rights over the equipment towards the Municipality.

Article 2

GIZ intends to:

- 2.1.** Contract Kosovo Telecom J.S.C Vala as an authorized telecommunication operator within the territory of Kosovo who shall procure the necessary equipment, carry out

installation of the Wi-Fi network and provide internet and maintenance service for at least 18 (eighteen) months.

2.2. Assist in the process of transferring ownership of the equipment from the telecommunication operator to the Municipality.

2.3. Undertake measures and activities to secure financial resources, to continue the support activities for this project for an additional period of 18 (eighteen) months.

GIZ shall not be held liable for any damage arising in connection with the equipment that is the subject of this Memorandum or in connection with its use by the Municipality or any third party.

Article 3

The Municipality intends to undertake the following actions:

3.1. Appoint a contact person responsible for communication and coordination with the engaged telecommunication operator and with GIZ.

Name of person: Labinot Kajtazi

E-mail: labinot.kajtazi@rks-gov.net.

Telephone: +38344600596

For any change of the contact person, the Municipality shall notify GIZ without delay.

3.2. In cooperation with the telecommunication operator, determine and propose the exact location(s) where the Wi-Fi equipment and access points shall be installed, taking into account technical and security requirements as well as the public interest.

3.3. Obtain all necessary internal decisions, as well as approvals, permits, and licenses from other competent authorities in the Kosovo required for the lawful installation and operation of the Wi-Fi network at the proposed locations (including permits for the use of public spaces, construction permits, and conditions and approvals prescribed by applicable legislation on electronic communications, personal data protection, and information systems security, etc.), and, at the same time, to comply with the applicable legislation in Kosovo

3.4. Provide free access to an appropriate source/connection of electrical power for each location, required for powering and operating the equipment.

3.5. Ensure appropriate protection of the equipment installed in its facilities or in public areas under its competence and take measures to prevent damage and theft.

3.6. Upon the expiry of the initial support period of 18 (eighteen) or 36 (thirty-six) months, intend to continue providing the free wireless internet service and equipment maintenance for an additional period of at least 12 (twelve) months. The Municipality shall have the right to provide the service in cooperation with the same telecommunication operator, or to select another operator.

3.7. Comply with all instructions given by the telecom operator regarding the use of the equipment; and if insurance is handed over together with the equipment, comply with the conditions determined by the competent insurance company.

To this end, the partners may jointly explore and coordinate on the aforementioned activities of mutual interest, which would be implemented by separate agreements in mutual understanding and in conformity with the regulations and policies of both partners.

3. Term

This MoU shall enter into force on the date of its signing by the partners and will expire on the date of completion of all activities contemplated herein. Changes and Amendments to this Memorandum may be commenced only by the mutual written consent of the partners.

4. Non-binding nature

Nothing in this MoU shall be understood or construed as a binding right or obligation of the partners or as obligating the undersigning partners hereto to finally conclude any agreement. In particular, this MoU in no way restricts either partner from pursuing similar activities on its own or from participating in similar activities with other public or private agencies, organizations, and individuals and shall not provide exclusivity between the partners in the scope of any cooperation, does not endorse a specific entity, does not create any rights in any person, and does not create any obligations for any third party.

This Memorandum does not create, and shall not be construed as creating, any financial or other obligations for the partners. Any obligation undertaken by either partner within the framework of this Memorandum shall be subject to the availability of resources and the specific consideration and decision of the partner undertaking it. A binding contractual relationship between the partners may be established only by concluding a separate written agreement. Any disputes that may arise regarding the interpretation and implementation of this Memorandum shall be resolved amicably, in the spirit of cooperation and mutual respect.

This Memorandum is prepared in Albanian and English versions; in the event of any inconsistency the English version shall prevail. This Memorandum is executed in two (2) identical originals, one (1) for each partner. In consideration of the foregoing, the partners, having reached mutual agreement and acting of their free will, hereby execute this Memorandum as follows:

Deutsche Gesellschaft für

Municipality of Podujevë

Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

GENERAL DIRECTOR OF GIZ Kosovo and North Macedonia

MAYOR


David Oberhuber



Shpejtim Balliqi
